



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 13278 Prot.

Tiranë, më 29.12 2017

UDHËZIM

Nr. 27, datë 29.12 2017

“PËR
STRUKTURAT E BRENDSHME AKADEMIKE DHE ADMINISTRATIVE NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 129, të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Struktura e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë të organizohen të ndara për nga varësia hierarkike dhe institucionale.
2. Struktura akademike në nivel institucioni të konsiderohen:
 - a) Senati Akademik;
 - b) Rektorati;
 - c) Rektori;
 - d) Zv.Rektori/ët.
3. Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel institucioni të konsiderohen:
 - a) Strukturat e kurrikulave;
 - b) Strukturat e kërkimit shkencor;
 - c) Strukturat e projekteve;
 - d) Strukturat e promovimit akademik dhe botimeve;
 - e) Strukturat e marrëdhënieve me publikun;
 - f) Strukturat e marrëdhënieve me jashtë;
 - g) Strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë;
 - h) Strukturat e karrierës;
 - i) Strukturat e bibliotekave;
 - j) Strukturat juridike;
 - k) Strukturat e teknologjisë së informacionit;
 - l) Strukturat e burimeve njerëzore;
 - m) Strukturat e arkiv-protokollit;
 - n) Asistent i Rektorit.
4. Struktura administrative në nivel institucioni të konsiderohen:
 - a) Bordi i Administrimit;

- b) Administratori i institucionit;
 - c) Strukturat e auditimit të brendshëm;
 - d) Strukturat ekonomike;
 - e) Strukturat e investimeve;
 - f) Strukturat e prokurimeve;
 - g) Strukturat e shërbimeve;
5. Struktura akademike në nivel njësie kryesore të konsiderohen:
- a) Asambleja e Personelit Akademik;
 - b) Dekanati;
 - c) Dekani;
 - d) Zv.Dekani/ët.
6. Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore të konsiderohen:
- a) Strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë;
 - b) Strukturat e karrierës;
 - c) Strukturat e bibliotekave;
 - d) Strukturat e burimeve njerëzore;
 - e) Strukturat e arkiv-protokollit.
 - f) Strukturat e teknologjisë së informacionit;
 - g) Sekretaritë mësimore të njësive kryesore;
 - h) Asistent i dekanit.
7. Struktura administrative në nivel njësie kryesore të konsiderohen:
- a) Administratori i njësisë kryesore;
 - b) Strukturat ekonomike;
 - c) Strukturat e shërbimeve;
8. Struktura akademike në nivel njësie bazë të konsiderohen:
- a) Drejtuesi i departamentit;
 - b) Grupet mësimore/kërkimore shkencore që përbehen nga jo me pak se 5 personel akademik me kohë të plotë.
9. Struktura ndihmës akademike me karakter akademik në nivel njësie bazë të konsiderohen:
- a) Laborantët;
 - b) Teknikët.
10. Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel njësie bazë të konsiderohen:
- a) Sekretaritë në departamente (në rastet me mbi 21 personel akademik në nivel njësie bazë me kohë të plotë).
11. Struktura administrative në nivel njësie bazë të konsiderohen:
- a) Administratori i njësisë baze, (në rastet me mbi 21 personel akademik në nivel njësie bazë me kohë të plotë).

12. Me përjashtim të strukturave akademike dhe administrative të përcaktuara në Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", organizimi i strukturave të tjera, bëhet në varësi të numrit të përgjithshëm të personelit akademik dhe atij administrativ, numrit të studentëve dhe buxhetit të institucionit institucionin publik të arsimit të lartë.
13. Në nivel institucional, strukturat e mësipërme me personel ndihmës akademik me karakter administrativ dhe personel administrativ organizohen në drejtori, sektorë dhe zyra, ku secila drejtori nuk mund të ketë më pak se dy sektorë apo zyra, secili sektor apo zyre nuk mund të ketë më pak se tre specialistë.
14. Në nivel njësie kryesore, strukturat organizohen në degë dhe secila degë nuk mund të ketë më pak se dy punonjës.
15. Struktura akademike, ndihmës akademike me karakter akademik dhe ndihmës akademike me karakter administrativ, janë në varësi të rektorit të institucionin publik të arsimit të lartë. Strukturat akademike, ndihmës akademike me karakter akademik dhe ndihmës akademike me karakter administrativ, në nivel njësie kryesore, kanë varësi funksionale nga dekani i njësisë kryesore përkatëse.
16. Struktura administrative është në varësi të administratorit të institucionin publik të arsimit të lartë. Struktura administrative në nivel njësie kryesore, ka varësi funksionale nga administratori i njësisë kryesore përkatëse.
17. Strukturat e auditimit të brendshëm, janë në varësi të Bordit të Administrimit të institucionin publik të arsimit të lartë.
18. Strukturat juridike, burimeve njerëzore, arkiv-protokollit dhe teknologjisë së informacionit në nivel institucioni apo njësie kryesore, ushtojnë veprimtarinë e tyre në funksion të të gjitha strukturave në institucion.
19. Struktura organizative dhe organigrama e institucionit publik të arsimit të lartë, të jenë pjesë e statutit të institucionet publik të arsimit të lartë, sipas kërkesave të nenit 33, të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë".
20. Ngarkohen institucionet publik të arsimit të lartë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

